



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr. 31

Prishtinë, më 07.06.2022, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-506

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albena Reshitaj-nënkryetare, Jahja Koka, Arijeta Rexhepi, Arijeta Fejza, Adriana Matoshi, Vlora Dumoshi dhe Jasmina Dediq.

Munguan: Ardian Gola, Enis Kervan, Eliza Hoxha dhe Ardian Kastrati.

Të ftuar: Hasnije Ilazi-kryetare e KSHC-së, Krenare Pirava-Nuçi, Gëzim Tosuni, Rozafa Koliqi e Dukagjin Zeka, anëtarë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë dhe Arianit Krasniqi, zyrtar në Agjencinë e Akreditimit.

Përfaqësues të tjerë: Liridona Ademaj-ORCA, Dardan Bujupi-IPS “Musine Kokalari” dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi: Albena Reshitaj, nënkryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.5.2022;**
Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për vitin 2021 - të ftuar: anëtarët e Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC);
- 3. Të ndryshme.**

Nënkryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.5.2022

Procesverbali, i mbledhjes së mbajtur më 24.5.2022, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim për vitin 2021

Albena Reshitaj, kërkoi nga kryesuesja e Këshillit Shtetëror të Cilësisë që të bëj prezantimin e raportit vjetor të punës.

Hasnije Ilazi, tha se raportit vjetor i punës së Këshillit është dorëzuar në fund të tremujorit të parë, ashtu siç është kërkuar sipas legjislacionit. Një pjesë e raportit i dedikohet punës që është bërë nga bordi paraprak, pra deri në muajin korrik, janë punë të cilat kanë qenë nën përgjegjësinë e tyre. Për periudhë një (1) vjeçare konsideron se është bërë punë e rëndësishme në drejtim të forcimit të mekanizmave, përmes së cilave do të sigurohet cilësia në arsimin e lartë. Me marrjen e mandatit në proces të akreditimit kanë qenë 239 programe dhe institucioneve që kanë mbetur për shkak të vonesës në plotësimin e vendeve vakante të bordit. Në këtë proces kemi pasur presion nga institucionet e arsimit të lartë, për shkak të hapjes së konkurseve për pranimin e studentëve të rinj nga ana e tyre. Si prioritetet tjetër i punës së agjencionit dhe bordit është kthimi në ENQA dhe EQAR. Tha se janë hartuar dokumente të cilat garantojnë funksionimin e agjencisë dhe ngritjen e cilësisë, siç është strategjia punës së Agjencisë dhe Këshillit për pesë (5) vite, kemi marrë pjesë në hartimin e ligjit për AKA-në. Përmendi pjesëmarrjen e tyre në një konferencë në Gjermani ku pjesëmarrës ishin përfaqësuesit më të lartë të ENQA-s dhe EQAR-it, ku është diskutuar po ashtu rreth procedurave si duhet të veprojmë për rikthim në këto institucione. Kërkoi që pa humbur kohë të miratohet ligji për AKA dhe t' i hapet rrugë procesit të anëtarësimit, si dhe mos të ndryshohet statusi i Agjencisë sepse si agjencia ekzekutive nuk mund të rikthehemi në ENQA. Në shtator të këtij viti do të vij një delegacion i ENQA-s, i cili do të bëjë një rishikim të progresit e për këtë jemi duke u përgaditur intensivisht. Gjatë vitit 2021, përveç dokumenteve strategjike kemi prodhuar edhe planin e aktiviteteve, manualin e monitorimit, i cili ka qenë një dokument i munguar deri më tani, ku gjatë dhjetë (10) ditëve të fundit ka filluar dhe monitorimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë nga AKA-ja. Kemi pas një takim së bashku me një profesoreshë që ka ardhur nga Ambasada Amerikane përmes programit Fulbright, ku është përfunduar studimi i fizibilitetit për digjitalizimin e proceseve në AKA, gjë që do të ndihmojë edhe më tepër në transparencën e punës në Agjenci. Po ashtu, një prej punëve të cilat janë kryer ka qenë plotësimi i disa standardeve për akreditim dhe tani jemi në një periudhë kur kemi filluar për rishikimin e tërësishëm të standardeve për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë. Kemi pasur një trajnim tre-ditor në maj, me një përfaqësuese nga Agjencioni i Akreditimit të Kroacisë, e cila ka qenë vlerësuese në raportin i cili realisht e ka larguar Kosovën nga ENQA. Aktualisht jemi në proces të përfundimit të proceseve të akreditimit për këtë vit, vizitat e fundit do të jenë rreth 20 qershorit, ndërsa do kemi mbledhjen e radhës më 30 qershor, ku do marrim vendimet për akreditimet të cilat janë në procedurë e sipër,

në mënyrë që konkurset që duhet t'i shpallin Institucionet e Arsimit të Lartë të jenë të shpallura me kohë.

Albena Reshitaj, tha se raporti i punës së KSHC-së për vitin 2021 lë për të dëshiruar, duke pasur parasysh disa gabime apo mospërputhje në mes të numrit të programeve të akredituara dhe të pa akredituara gabime të cilat nuk do të duheshin të ishin aq më tepër në këtë raport. Në faqen 7 të raportit thuhet që kërkesa për akreditim mund të bëhet nga vetë Institucioni i Arsimit të Lartë për t'u vlerësuar në nivel institucional apo të programeve të studimit nga MASHTI dhe nga KSHC në raste të veçanta. Cila është baza ligjore që KSHC ka mundësi me paraqitë kërkesë për akreditim të programeve. Po ashtu në raport i referoheni një vlerësimi të vitit 2018, i cili nuk i përgjigjet periudhës së raportimit. Në të njëjtën faqe të raportit përmenden ndërhyrjet e politikës në Agjenci të cilat kanë ndodhur gjatë vitit 2018, që nuk i përgjigjen periudhës së raportimit, raporti duhet të përmbaj aktivitetet dhe punën e Agjencisë për vitin 2021.

Në faqe 9, permendet përbërja e KSHC-së që kanë marrë pjesë në mbledhjen e parë të vitit 2021, por nuk është evidentuar dhe i mungon raportit dorëheqja e anëtarëve të Këshillit, kur dihet se nga këto dorëheqje Këshilli ka mbetur pa vendimmarrje dhe ka qenë jofunksional. Në mbledhjen e dytë të KSHC-së për vitin 2021, e cila ishte dhe mbledhje konstituive nuk e keni prezantuar përbërja e saktë të KSHC-së sipas vendimit të Kuvendit të datës 17.06.2021, ku ka qenë: Hasnije Ilazi, Gëzim Tosuni, Krenare Pireva-Nuçi, Seb Bytyçi, Alison Felce, Cassie L. Barnhard dhe Werner.J.Stueber. Në raport po ashtu nuk është evidentuar dorëheqja e tre anëtarëve ndërkombëtarë e cila ka ndodhur më 26.07.2021 dhe 27.07.2021 si rrjedhojë KSHC ka mbetur jofunksionale. Në raport po ashtu nuk është paraqitur data e emërimit të anëtarit të ri ndërkombëtar Klemen Miklaviç, që tani është nënkryetar, emërimi i tij është bërë më 19.10.2021 dhe kjo mungon në raport. Gjithashtu, te pika 3.1. te tabela 1, aktivitetet kryesore të KSHC-së në periudhën korrik-dhjetor të vitit 2021, thuhet se KSHC, pas ratifikimit në Kuvendin e Kosovës, merr vendim për 239 programe akademike që ishin në proces për akreditim. Programet e akredituara për periudhën 2021-2022, janë bashkangjitur në aneksin 1. këtu shënon, korrik 2021 dhe gusht 2021 pse nuk janë vendosur datat e mbajtjes së mbledhjeve të KSHC-së, sikurse janë në tabelën vijuese dhe nuk ka patur aktivitet të evidentuar për muajin gusht dhe pse nuk figuron kjo tabelë, pyeti ajo. Cila është data e marrjes së vendimit për 239 programe akademike. Te tabela 2, e kemi datën 21.06.2021 dhe 28.06.2021, mbledhjen e 86 të KSHC-së, domethënë mbledhjen konstituive të përbërjes së re. Në faqen 9 të këtij raporti, thuhet se mbledhja konstituive e KSHC-së është mbajtur më 28.06.2021, andaj pse figuron këtu edhe data 21.06.2021, cila është data e konstituimit.

Në pikën 8 të tabelës 2, e keni datën 18.10.2021 – mbledhja e 92-të e KSHC-së, është mbledhja për miratimin e raportit për vlerësimin e programeve të doktoratës deri sa në web-faqën e Agjencisë figuron data e mbajtjes së mbledhjes më 28.10.2021, dmth. kemi një diskrepancë në mes të datave të prezantuara.

Te pika 5, procesi i vlerësimit dhe akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë në vitin 2020-2021, përmbajtja e raportit i referohet vitit 2021, andaj pse është cekur viti 2020 në këtë raport. Në faqen 12, Agjencia Kosovare për Akreditim gjatë vitit 2021 ka arritur të përfundojë me sukses procesin e akreditimit për 239 programe akademike dhe 9 procese të akreditimit në nivel të Institucioneve të Arsimit të Lartë. Prej këtij numri, 199 raporte/vendime janë pozitive për akreditim, ndërsa 40 janë rekomanduar që të mos akreditohen, në vijim do të shofim mospërputhje të shifrave të prezantuara, thuhet se, janë akredituar 124 programe të institucioneve publike dhe

74 të institucione private. Nëse i mbledhin këto del se janë 198 programe në total që janë të akredituara dhe jo 199. Pastaj thuhet, 16 programe të institucioneve publike dhe 15 programe të institucioneve private nuk janë akredituar, nëse i mbledhim dalin 31 programe dhe jo 40 siç shkruan në raport. Pra, nëse i mbledhim të gjitha këto del se nuk i kemi 239 programe të vlerësuara për akreditim, por 229. Në faqen 13, pika 5.1, akreditimi institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë, thuhet, në vitin 2021, Agjencia realizoi vlerësimin institucional të 11 Institucioneve të Arsimit të Lartë, prej tyre 2 ishin universitete publike, kurse 9 të tjera ishin kolegje private. Këtu është thënë që 11 institucione i janë nënshtruar vlerësimit institucional, ndërsa në faqen 12 të këtij raporti, keni thënë që keni kryer 9 vlerësime për Institucione të Arsimit të Lartë. Ajo pyeti se cili është numri i saktë. Pastaj, KSHC më 21.06.2021, mbajti mbledhjen e rregullt, në të cilën u analizuan dhe votuan raportet e ekspertëve ndërkombëtarë mbi vlerësimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë. Siç shihet në figurën 1, nga gjithsej 11 Institucione të Arsimit të Lartë të vlerësuara mbi bazën e rekomandimit të ekspertëve ndërkombëtarë, 7 nga këto Institucione u akredituan ndërsa 4 të tjera u refuzuan. Në raport thuhet se më 21.06.2021, është mbajtur mbledhja e rregullt e Këshillit, ndërsa në faqen 9 të këtij raporti është shkruar se më 28.06.2021 është mbajtur mbledhja konstituive. Në procesin e vlerësimit institucional, keni thënë se ishin të anagzhuar nëntë (9) ekspertë ndërkombëtarë - prej të cilëve tre (3) ishin studentë-ekspertë, ashtu siç kishte rekomanduar ENQA në rekomandimin e saj në raportin e vlerësimit për vitin 2019, sa ka qenë numri i ekspertëve të anagzhuar për secilin institucion veç e veç, a ka pas raste kur një ekspert ka qenë i angazhuar për dy (2) e më shumë institucione. Te faqja 14, pika 5.1.2, Akreditimi Institucional i Institucioneve Private të Arsimit të Lartë – këtu i keni shënuar numrin e Institucioneve dhe emrat e Institucioneve, te numri 7 i Institucionit, e keni shënuar kolegji UBT-Gjilan, edhe e keni shënuar – nuk akreditohet, në pikën 8 e keni shënuar kolegji UBT në kllapa (Gjilan) dhe Pejë, pastaj – ku keni shënuar që akreditohet për tre (3) vite, dhe kërkoi sqarim se për cilin qytet u akreditua ky institucion, pse Gjilani në kllapa kur më lart nuk është akredituar. Te pika 5.2.1., akreditimi i programeve të studimit në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë, thuhet se nga 140 programe akademike të universiteteve publike që ju nënshtruan vlerësimit për akreditim ose riakreditim në vitin 2021, 74 ishin të nivelit baçelor (ku janë përfshirë edhe dy programe të integruara), 61 të nivelit master dhe 5 programe të nivelit të doktoratës. Ka mospërputhje sa i përket numrit të programeve që janë akredituar dhe atyre që nuk janë akredituar. Kjo mospërputhje vërehet në pjesën tekstuale në faqen 14, si dhe në figurën e paraqitur në faqen 15. Fillimisht ka mospërputhje në numrin total të programeve, sepse thuhet se nga 140 programe, janë akredituar 124. Ndërsa në figurën 4, faqe 15, dalin që janë akredituar 121 programe. Mospërputhje kemi edhe te numri i programeve të akredituara dhe refuzuara në nivelin baçelor dhe master. Në raport thuhet se në nivelin baçelor janë vlerësuar 74 programe, prej tyre 68 janë akredituar dhe 2 janë refuzuar; që në total bëjnë 70 e jo 74. Nga një analizë del që janë refuzuar 6 programe. Në raport thuhet se në nivelin master, nga 61 programe të vlerësuar, 52 janë akredituar dhe 10 janë refuzuar. Që në total i bie se janë vlerësuar 62 programe e jo 61. Përndryshe, numri i programeve të refuzuara do duhej të ishte 9 dhe jo 10. Gjithashtu te pjesa e po kësaj tablele, ka mospërputhje në pjesën tekstuale të paraqitjes së fakteve. Te faqja 18, pika 9 – aktivitetet kryesore të Agjencisë së Akreditimit, pika 9.1 thuhet: Agjencia ka përfunduar me sukses proceset e akreditimit për 239 programe studimore. Do duhej jo 239, por 229, sepse 140 programe të Institucioneve Publike dhe 89 programe të Institucioneve Private bëjnë gjithsej 229 programe. Pastaj, e kemi atë pjesën tjetër ku duhet sqaruar

numri 199 dhe 40. Sa i përket numrit 199, thuhet për 199 programe merret vendim pozitiv, kurse për 40 programe të tjera merret vendim që të mos akreditohen. Në të dhënat e paraqitura thuhet që janë akredituar 124 programe të institucioneve publike dhe 74 programe të atyre private, që në total bëjnë 198 dhe jo 199 programe. Pra, duhet ta dijmë se ku po mbetet një (1) program. Sa i përket numrit 40 – në të dhënat e paraqitura paraprakisht thuhet se janë refuzuar 16 programe të institucioneve publike dhe 15 programe të atyre private, që në total bëjnë 31 programe dhe jo 40, pra ku po mbesin edhe nëntë (9) programe të tjera. Këto janë disa nga vërejtjet pas analizimit të raportit dhe tabelave që konsideroj që ky raport duhet të rishqyrtohet edhe një herë.

Jahja Koka, propozoi që të gjitha këto gabime që janë bërë të cilat u prezantuan nga parafolsja, e ku sipas tij nuk bëhet fjalë për teknike apo të lekturimit por për gabime përmbajtësore, prandaj të bëhet edhe një herë shkrimi i raportit në mënyrë serioze nga anëtarët e KSHC-së ngase me këtë raport vjen në shprehje kredibiliteti i KSHC-së propozon që edhe njëherë të rishiqohet dhe të vijë përsëri për shqyrtim të raportit, sepse si tillë ky raport është jo profesional.

Vlora Dumoshi, tha se raportin e punës së KSHC-së e ka analizuar në tërësi, pajtohet me të gjitha pasaktësitë e cakura nga kryesuesja e mbledhjes. Këto gabime që i hasëm, mund të jenë qoftë teknike apo qoftë sepse raporti është hartuar me nguti prandaj disa gabime që i vërejtëm në raport me të vërtetë janë të pafalshme dhe për të njëjtat kërkoj sqarim për pasaktësitë që përmban raporti, duke pasur parash se nga KSHC kërkojmë cilësi.

Hasnije Ilazi, tha se sa i përket bazës ligjore se në cilat rastet specifike KShC mundet me apliku për akreditim, ajo nuk është e specifikuar, kjo parashihet me udhëzimin administrativ të vitit 2018 mbi të cilin funksionon AKA-ja dhe KSHC-ja.

Krenare Pireva, procesi i hartimit të këtij raporti i ka dy faza, në fazën e parë, janë marrë të dhënat nga Agjencia në proceset e rregullta dhe faza e dytë ku këto të dhëna të Agjencisë janë përpunuar në nivelin e bordit të KSHC-së, bashkë me të dhënat tona. Raporti është kredibil në atë që nuk ka vetëm përshkrim të proceseve, siç ka ndodhur më parë, por ka edhe të dhëna analitike për të cilat mund të diskutojmë. Sa i përket mospërputhshmërisë së dy instancave të ndryshme, ju informoj që, brenda raportit ekzistojnë të dhëna që janë marrë nga procesi i akreditimit i udhëhequr nga bordi i kaluar dhe të dhëna që pasojnë pas korrikut të vendimeve që janë marrë nga bordi aktual. Prandaj kemi dy lloje shifrash, një shifër për një periudhë tjetër kohore dhe një shifër tjetër për periudhën tjetër. Sa i përket komentit të tabela 2, lidhur me mbledhjen konstituive, përkundër që figurojnë dy data të ndryshme, është një mbledhje e vetme pasi ka filluar më 21 qershor dhe ka mbaruar më 28 qershor 2021.

Hasnije Ilazi, është e vërtetë që më 21 qershor ka qenë mbledhja e parë konstituive, ku ka qenë prezenca e ministres, ashtu siç ka qenë e paraparë me legjislacion. Më 28 qershor është zgjedhur kryetari dhe nënkryetari. Deri sa nuk është zgjedhur kryetari dhe nënkryetari i bordit të KSHC-së, nuk është konsideruar që është përfunduar procesi i konstituimit, ku deri atëherë (më datë 28) ministrja ka udhëhequr me këto mbledhje. Prandaj figurojnë dy data mirëpo konsiderohet një mbledhje.

Albena Reshitaj, tha se në këtë raport është shkruar e kundërta e asaj që thoni tani, sepse në raport në faqe 9, pika 3.1 të funksionalizimit të KSHC-së pas ratifikimit të anëtarëve të rinjë në Kuvendin

e Kosovës, thuhet se, pas votimit të anëtarëve të rinj në qershor 2021, është mbajtur mbledhja e parë e KSHC-së, e drejtuar nga ministrja Nagavci më 28 qershor 2021. Është gabim kjo, ku unë dëshiroj që të jetë gabim teknik sepse përndryshe lë shumë për të dëshiruar.

Krenare Pireva, lidhur me pyetjen se nëntë (9) ekspertë ndërkombëtarë janë anagazhuar në procesin e vlerësimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë për akreditim dhe tre (3) prej tyre ishin studentë-ekspertë, sipas udhëzimeve dhe sugjerimeve të ESG standardeve, në çdo vlerësim rekomandohen të involvohen edhe studentët-ekspertë, prandaj ky rekomandim strikt jepet edhe nga ana jonë. Në shumicën e rasteve i kemi dy (2) profesorë-ekspertë dhe një (1) student-ekspert dhe ka raste kur e kemi raportit një me një. Prandaj, të dhënat e tilla statistikore nëse një (1) ekspert ka marrë pjesë në më shumë se dy (2) institucione për akreditim mund t'i vendosim si aneks të veçantë, sepse i kemi, por nuk janë të përfshira në këtë raport. Raporti i ka totalisht 18 anekse dhe mjaft tabela, ku nëse hyni brenda këtyre tabelave.

Albena Reshitaj: Nga analiza e raportit kam nxjerrë komentet dhe gabimet në numrin e programeve të akredituara dhe numrin e programeve të vlerësuara dhe jo të vlerësuara.

Krenare Pireva tha se çdo raport i ekspertëve është i publikuar në web faqe, brenda faqës së parë të çdo raporti janë të përfshirë emrat e ekspertëve të inkuadruar në secilën pjesë të vlerësimeve. Megjithatë, unë do të sigurohem që me e vendos edhe një tabelë shtesë mbrenda këtij raporti.

Hasnije Ilazi, tha se është e vërtetë që ka ndodhur që një apo dy ekspertë kanë vlerësuar disa institucione. Ku ndoshta pikërisht aty ka qenë ajo mospërputhja e nganjëherë është vështirë me e mbuluar fushën e akreditimit dhe ndodhë që i njëjti ekspert vie për të vlerësuar disa institucione.

Albena Reshitaj, prapë kërkoi sqarim lidhur me çështjen e ngitur sa i përket angazhimit të një eksperti në dy apo më shumë institucione. Ne e përcjellim punën e juaj edhe mbi atë që publikohet online, ju jeni këtu për me e mbrojtur raportin e juaj, ndërsa ne jemi për ta vlerësuar.

Vlora Dumoshi, tha se bazuar në informacionet që ka, vitin e kaluar nuk ka pasur proces të akreditimit nga bordi i kaluar i KSHC-së. Andaj është pasaktësi nëse ne këtë raport përfshini programe të akredituara nga borsi i kaluar. Mbështet propozimin e deputetit Jahja Koka, që të rishkruhet raporti dhe të vini përsëri për raportim.

Jasmina Dediq, kërkoi sqarim lidhur me mos përkthimin e raportit të punës së KSHC-së në gjuhën serbe dhe për këtë tha se do la lëshojë mbledhjen.

Dukagjin Zeka, tha se vitin e kaluar kemi berë një prezantim të shkurtër të gjashtë (6) mujorit të parë. Sa i përket procedurës, është e vërtetë ajo që tha deputetja Vlora Dumoshi se gjatë vitit të kaluar 2021 nuk ka patur proces të akreditimit, ka patur vetëm aprovim të apikacioneve të ekspertëve për vlerësim të procesit. Ndërsa janë futur në proces 239 programe dhe rezultatet janë ato të cilat u prezantuan në raportin në fjalë. Dorëheqja e anëtarëve të jashtëm në lidhje me deklarinimin e pasurisë, na ka lënë jofunksional si bord një muaj e gjysmë pas konstituimit.

Arjeta Fejza, tha se në raport janë përmendur një numër i programeve që nuk janë të akredituara, dhe më intereson se cili është mendimi juaj lidhur me këto programe dhe cila do të jetë e ardhmja e tyre – specifikiisht të disa programeve të cilat shpesh përkojnë me kërkesat e tregut të punës,

mirëpo aktualisht nuk janë të akredituara. Në pjesën veriore të Mitrovicës ku ekziston universiteti, pyeti se a keni kontakte dhe a mund të sugjeroni ndonjë model për zgjidhjen e çështjes rreth këtij universiteti. Po ashtu kërkoi ta dijë nëse KSHC planifikon të bëjë ndonjë studim lidhur me llojin e diplomave të cilat jepen aktualisht në Kosovë dhe ndoshta një perspektivë tuajën rreth modaliteteve të bashkëpunimit me Agjencinë e Akreditimit të Shqipërisë.

Jahja Koka, tha se kur është bërë përzgjedhja KSHC-së ka qenë shumë optimist, mirëpo, shfaqti pakënaqësi rreth mosakreditimit të katedrës së energjetikës në Universitetin e Prishtinës pasi që energjia sot është jetike, e veçmas në rastin e Kosovës.

Hasnije Ilazi: Ne mundemi me ju dërguar shpjegimin shtesë për secilën pikë që e kemi marrë si koment apo rekomandim nga ju. Ekzistojnë përgjegjësi të ndara mes KSHC-së dhe AKA-së. Ne jemi bordi, kurse AKA-ja është ajo pjesa administrative që mbledh të dhëna dhe statistika të cilat na ofrojnë neve. Të dhënat statistikore i takojnë pjesës administrative dhe për to do duhej përgjigjej drejtori ekzekutiv i AKA-së, i cili nuk është sot prezent. Për këtë pjesë të statistikave, mundemi me marrë një afat kohor që brenda një (1) jave apo kurdo që dëshironi me ju dërguar shpjegimet shtesë duke u përgjigjë në secilën prej pikave që i keni ngritur me të drejtë. Ne, si bordi i KSHC-së, nuk jemi ata që mundemi me e orientuar tregun e punës. Këtu vendos politika, nuk vendosim ne. Të vetmin mision që e kemi si Këshill dhe Agjencia është matja e cilësisë në arsim dhe ndërmarrja e hapave dhe vendosja e standardeve me qëllimin e ngritjes së kësaj cilësie. Të gjitha vendimet që i kemi marrë deri tani janë në përputhje me standardet e BE-së, përmes aplikimit të të cilave ne tentojmë prapë me u kthye në rrjetin e tyre. Çdo punë që e kemi bërë ka qenë vetëm mbi bazën e standardeve dhe legjislacionit. Cilësia në arsim është fushë në vete. Nëse keni çfarëdo argumenti apo fakti se akreditimet po bëhen ndryshe apo me standarde të dyfishta ekziston rruga institucionale dhe ju inkurajoj ta denonconi atë. Sa i përket universitetit në veriun e Mitrovicës, kjo është çështje politike dhe nuk lidhet me fushëveprimin tonë, ndërsa sa i përket llojit të diplomave është e përcaktuar sipas legjislacionit se çfarë lloj diplomash merrën. Sa i përket çështjes së programit të energjetikës, ne kemi pas para disa muajsh një takim me kryeministrin, ministren e arsimit dhe kryetarin e Komisionit për Arsim, kanë qenë edhe disa deputetë ku e kemi diskutuar këtë çështje. Duhet të jenë institucionet në nivel me standardet të cilat kërkohen për t'u akredituar, jo vetëm pse kemi nevojë dhe të akreditojmë çfarëdo programi duke u mbështet në këtë argument të nevojës. Kërkesat duhet me u plotësuar duke e përfillë cilësinë, kur plotësohen standardet, ka staf të mjaftueshëm, është infrastruktura e nevojshme, askush nuk ka qëllim që t'i ndalë proceset që janë të domosdoshme për shtetin. Ne, si Agjenci e Akreditimit, e kemi nënshkruar para disa muajsh një marrëveshje mirëkuptimi me Agjencinë e Akreditimit të Shqipërisë, para dy jave edhe me atë të Maqedonisë.

Krenare Pireva, sa i përket pjesës së energjetikës që u ngrit nga profesor Jahja, kritikant mund të drejtohen te menaxhmeti i lartë i universiteteve, për me punësuar profesorë si Gjota, Haxhiu dhe Dida, të cilët nuk janë aktualisht në universitet dhe duhet të kenë pasardhësit e tyre. Këshilli nuk hap e as nuk mbyllë programe, mirëpo bazohet në vendimet e ekspertëve, i cili nëse ka sugjeruar që mos të akreditohet.

Arijeta Rexhepi, tha se është me rëndësi të kemi cilësi në arsim, të rrisim transparencën gjatë procesit të akreditimit dhe të mos ketë ndërhyrje të politikës, me qëllim të rikthimit në ENQA dhe

EQAR. Gjithashtu, urojmë që mos të kemi raste sikurse disa studentë që kanë kryer shkollimin universitar në Universitetin e Prishtinës ndërsa diplomat e tyre edhe sot nuk janë të nostrifikuara. Në raport thuhet se aktivitetet kryesisht ndërlihen me procesin e vlerësimit dhe akreditimit të IAL-ve dhe programeve të tyre të studimit në nivelin e pestë, baçelor, master dhe të atyre të doktoratës. Në bazë të Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, Autoritetit Kombëtar i Kualifikimeve i takon niveli i pestë, që është cikli i shkurtër i Bolonjës apo post-sekondar. Pra, ky nivel i akreditimit a i takon Agjencionit të Akreditimit të Kosovës, apo Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, për shkak se kjo e fundit ka përgjegjësi për kualifikimet profesionale të këtij niveli. Te tabela e parë thotë: aktivitetet kryesore të KSHC-së në periudhën korrik-dhjetor 2021 – KSHC në planin e veprimit inicon komunikimin në mes të Agjencionit të Akreditimit dhe ENQA-s, që është kryer në dhjetor të vitit 2021. A mund të na njoftoni për aktivitetet që i keni zhvilluar me ENQA-n dhe sa janë realizuar prioritetet. Procesi i akreditimit në Kosovë është vlerësuar pozitivisht në raportin e Komisionit Evropian për Kosovën, ku kjo gjë është pozitive dhe jep shpresë për një rikthim në ENQA dhe EQAR. Te Komisioni i Ankesave, janë dy (2) anëtarë më pak në këtë komision, ku edhe gjatë diskutimeve u trajtuan disa çështje që diku akreditohet ndonjë program i ngjashëm e diku jo. Prandaj, a janë plotësuar dy (2) vendet vakante në këtë Komision që janë boshë nga viti 2021. E kemi studimin e fizibilitetit për digjitalizim, ku e përmendet edhe në fillim që ishte një hap jashtëzakonisht i rëndësishëm për Agjencionin dhe për transparencën publike. Nga KSHC është aprovuar metodologjia e monitorimit dhe procedurave pasakredituese, ku KSHC ka aprovuar dokumentin për monitorim dhe procedura pasakredituese dhe kur do të fillon zbatimi i këtyre procedurave, si dhe rreth grantit të përfutur nga Ambasada Amerikane për rritjen e përfshirjes së studentëve në vendimmarrje në sigurimin e cilësisë. Sa i përket ekspertëve të anagazhuar në procesin e vlerësimit, kërkon sqarim se sipas cilave kritere bëhet përzgjedhja e një eksperti ndërkombëtar. Ajo kërkoi që të ketë një ndërlidhje mes Këshillit, MASHT-it dhe programeve studimore me qëllimin të orientimit të tyre drejt nevojave të tregut të punës. Javën e kaluar kam shkëmbyer një e-mail me AKA-në lidhur me një program të infermierisë që i takon nivelit të pestë, që e ofron kolegji UNIVERSUM. Ku në bazë të studentëve (mbi 250), ata e ndjekin një program të infermierisë nga viti 2021/22, kur kanë pyetur se a është i akredituar dhe kanë bërë një vetëhulumtim, del se ky program i këtij kolegji nuk është i akredituar dhe ku është çalimi më i madh i kolegjeve private në procesin e akreditimit.

Hasnije Ilazi, tha se sa i përket vendeve vakante në Komisionin e Ankesave kjo është kompetencë e AKA-së dhe MASHTI-t, ku fatmirësisht ky proces ka përfunduar. Sa i përket monitorimit, e thashë edhe në fillim se monitorimi tanimë ka filluar. Ka qenë para dy jave në dy kolegje private (UBT dhe AAB), dhe në Fakultetin e Edukimit në UP. Nuk mundemi me vendos që një program mos të akreditohet mbi argumentin e mjaftueshmërisë së numrit të studentëve apo ngopjes së tregut me të diplomuar të asaj fushe, për këtë duhet bërë një analizë e tregut të punës dhe duhet të bëhet dallimi në mes tregut të punës dhe nevojave të shoqërisë. Për ato IAL që nuk janë të akredituara nuk kanë kompetencë as KSHC-ja dhe as AKA-ja. Ne i kemi bërë një fushatë informuese dhe krejt kjo transparenca edhe në web -faqe të Agjencionit të Akreditimit, ku secili kandidat potencial që dëshiron me studiuar në ndonjë IAL të vendit mundet me u informuar nëse programi është i akredituar apo jo. Nëse ka Institucione të Arsimit të Lartë që regjistrojnë studentë duke mos qenë të akredituar, atëherë është kompetencë e Ministrisë dhe Inspektoriatit të Arsimit të merret me ta. Sa i përket kolegjeve se ku çalojnë ato, shpeshherë mënyra përmes së cilës ata dëshirojnë të

akreditohen është mjaft improvizuese. Mund të themi ashtu sepse, ndonjëherë ndodh që një institucion vije përnjëherë me 40 programe për t'i akredituar dhe t' i shoh se nuk ka kapacitete infrastrukturore, kadrovike, etj. Dhe nga ajo që kemi parë deri tash, është në rend të parë mungesa e stafit të kualifikuar i cili është i mangët. Mandej, ky staf plotësohet me staf akademik që vije nga Shqipëria, Maqedonia apo vende të tjera të rajonit dhe me diploma që nuk janë shumë valide. Prandaj, do të propozoj që këto kolegje të profilizohen, sepse në fushat ku kanë eksperta janë lidere në vend. Për ne, si Këshill, nuk ka diskriminime të tilla si, privat apo publik. Për ne të gjithë janë të barabartë. Por e kemi vërejtur se në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë mungon infrastruktura në rend të parë, ndërsa tek ato Private, stafi akademik i kualifikuar.

Arianit Krasniqi, tha se sa i përket programeve të nivelit të pestë të cilat akreditohen edhe nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve edhe nga Agjencia e Akreditimit, dallimi është që programet e nivelit të pestë, që janë programe puro-profesionale, janë kompetencë kryekëput e Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve. Programet profesionale që ofrohen në Institucionet e Arsimit të Lartë, ato janë kompetencë e Agjencionit të Akreditimit dhe sigurisht që kërkohen dhe një sërë kriteresh, ku bartësit përpos kualifikimit duhet të kenë edhe përvojën e ushtrimit të profesionit në industri. Sa i përket projektit të realizuar nga grandit i fituar nga Ambasada Amerikane, ky projekt ka përfunduar javën e kaluar. Janë mbajtur takime me përfaqësuesit e Arsimit të Lartë dhe përfaqësuesit e studentëve. Takime të veçanta, ku është prezantuar metodologjia e përfshirjes së studentëve në organet vendimmarrëse të sigurimit të cilësisë në Kosovë, kjo metodologji i rekomandon institucioneve të sigurimit të cilësisë në universitete përfshirjen e studentëve dhe gjithashtu edhe Agjencisë së Akreditimit, që të kenë pjesë të sajën përfaqësues të studentëve me të drejta të plota.

Gëzim Tosuni, sa i përket përzgjedhjes së ekspertëve ndërkombëtarë, ne e kemi trashëguar një situatë me një databazë të ekspertëve, të cilën ne, si Këshill, në mbledhjen paraprake kemi marrë vendim për me e perditës, tani është hapur thirrja për ekspertë të jashtëm, ku do të jetë e hapur gjatë tërë vitit dhe ata do të aplikojnë për t'u përfshirë në procesin e akreditimit. Do të kërkohet edhe prej ekspertëve aktual për t'u përfshirë në databazë për të aplikuar, nëse kanë interes për të vazhdu me qenë pjesë.

Hasnije Ilazi, tha se ekspertët aplikojnë vetë, zakonisht llobojmë përmes agjencioneve që t'i inkurajojmë ekspertë ndërkombëtarë që të aplikojnë. Sepse ndonjëherë me të vërtetë kemi mungesë të ekspertëve për një fushë të caktuar dhe duhet gjetur një ekspert i fushës së përfaqësuar.

Adriana Matoshi, tha se i pati dy çështje për të ngritur por për njërin vetëm se e mori përgjigjen, ndërsa çështja e dytë ka të bëjë me atë se cilin model e sugjeroni që duhet ta ndjek Kosova për sigurimin e cilësisë.

Hasnije Ilazi, sa i përket modelit, ajo tha se ne të gjithë jemi të orientuar kah perëndimi. Modeli amerikan është shumë ndryshe nga ai i joni, dhe në rend të parë orientimi jonë është kah Bashkimi Evropian. Dhe tash është shumë mirë që ka filluar iniciativa për përfshirje në Këshill të Evropës, sepse aty përfshihet edhe sistemi i Bolonjës.

Jahja Koka, tha se vërejtjet rreth raportit duhet t'i kuptojnë si dashamirësi sepse qëllimi është që KSHC të performojë sa më mirë.

Arjeta Fejza: Kërkoj sqarim nga KSHC se gjatë procesit të akreditimit a vlerësohet edhe ofrimi i mundësisë së praktikës nga ana e universiteteve dhe kolegjeve.

Hasnije Ilazi, tha se praktika është një ndër kriteret kryesore kur akreditohen programet dhe institucionet, me plotësimin e fundit të standardeve që kemi bërë, kemi shtuar disa kritere për objekte dhe për infrastrukturën, ka qenë në rend të parë për shembull për programin e mjeksisë së përgjithshme; që t'i ofrojnë programet e tilla atëherë duhet me plotësuar pjesën e infrastrukturës që lidhet me praktikën. Ekspertët e kanë praktikën një prej orientimeve kryesore se kur e vlerësojnë programin dhe në bazë të atyre vlerësimeve ne i marrim vendimet.

Albena Reshitaj: Ne të gjithë po dakordohemi që edhe një herë raporti të rishikohet nga ju, të merren parasysh komentet tona dhe të procedohet serish një raport i përmirësuar.

4. Të ndryshme

Arjeta Rexhepi, propozoi që ditën e martë më 14.06.2022 të realizohet një vizitë pune në Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan me propozimin për realizimin e vizitës së Komisionit në në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i Komisionit.

Albena Reshitaj,

Nënkryetarja e Komisionit